



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.1588/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Ramush Bardiqi, në çështjen përmbarimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli në Prishtinë, rr. “Armend Daci”, nr. 1, kundër debitorit “Musliu Brothers” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810776693 dhe seli në Lluzhan, Magjistralja Podujevë, në çështjen përmbarimore, për shkak të borxhit në bazë të dokumentit përmbarimor, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1588/23 dt. 25.10.2023, më datën 14.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit “Musliu Brothers” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810776693 dhe seli në Lluzhan, Magjistralja Podujevë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1588/23 dt. 25.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr. 1588/23 dt. 25.10.2023, në piken I të dispozitivit e ka refuzuar në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Musliu Brothers” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810776693, të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 122/23, i lejuar më datë 02.06.2023, nga Përmbaruesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi. Ndërsa në piken II të dispozitivit Urdhrit Përmbarimor P.nr. 122/23, i lejuar më datë 02.06.2023, nga Përmbaruesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi, ka mbetur në fuqi.

Ankesë ka paraqitur në afat ligjor debitori (*me pretendimet si në ankese*) me propozimin që të aprovohet si e bazuar ankesa , të anulohet aktvendim KPPP.nr.1588/23 të datës 25.10.2023 i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Ceshtje Ekonomike, si i kundërligjshëm me kundërshtim me dispozitat materiale të LPP-së, LPPA-se dhe LPK-së, dhe

lënda ti kthehet të njëjtës gjykatë në rivendosje, apo të aprovohet ankesa dhe të anulohet Urdhri Përmbarrimor P.nr.123/23 të dt.02.06.2023.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar kreditori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Përmbarruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, mbi bazën e dokumentit përmbarrimor; Aktvendimit nr. 4224, të datës 27.10.2020, ka lejuar Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 122/23, të datës 02.06.2023, me të cilin është obliguar debitori “Musliu Brothers” Sh.P.K., që kreditorit t’ia paguaj shumën e borxhit në lartësi prej EUR 6,280.93, në emër të aktvendimit për gjobë administrative, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarrimor, me arsyetim se urdhri është nxjerr në kundërshtim me dispozitat nga neni 144.5 të LPPA, ngase kreditori nuk ka shqyrtuar ankesën e debitorit të cilën e ka paraqitur me datë 07.12.2020 andaj aktvendimi mbi të cilin është lejuar urdhri nuk është i ekzekutueshëm. Me tej, ka shtuar se debitorit i është shkëlur e drejta për shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore ngase kreditori nuk ka vendosur në këtë çështje administrative në mënyrë meritore dhe sipas dispozitave të LPPA-së. Tutje, ka theksuar se sipas nenit 24.3 të LPP, është përcaktuar se vendimi në procedurë administrative është i përmbarrueshëm nëse si i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura, ndërsa në rastin konkret urdhri është në kundërshtim me dispozitat nga neni 144 të LPP-së, me të cilin është përcaktuar se “1.Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar; 1.2. njoftimin e palës, me aktin, kur sipas ligjit, nuk lejohet ankesa; 1.3. njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues 1.4. njoftimin e palës me aktin e ndalimit të efektit pezullues të ankesës, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 130 të këtij Ligji, apo 1.5. njoftimin e palës për refuzimin e ankesës.” Në fund, ka theksuar se prapësimi i debitorit gjen mbështetje në nenin 71, pika 1.1 të LPP-së, ngase vendimi në fjalë nuk ka titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhri mbi lejimin e përmbarrimit të anulohet.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 1588/23 dt. 25.10.2023 e ka refuzuar në tërësi si i pabazuar

prapësimi i debitorit “Musliu Brothers” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810776693, të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarrimor P.nr. 122/23, i lejuar më datë 02.06.2023, nga Përmbarruesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi. Ndërsa në piken II të dispozitivit Urdhrit Përmbarrimor P.nr. 122/23, i lejuar më datë 02.06.2023, nga Përmbarruesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi, ka mbetur në fuqi, duke vendosur me decidivishtë sikur në dispozitiv të të njëjtit.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë nuk i ka pranuar pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave të ligjit të procedurës përmbarrimore, pasi që gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga ndërjyqësit, ka vendosur drejtë në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin e Procedurës Përmbarrimore, Kjo gjykate vlerëson se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit dhe e ka lënë në fuqi urdhrin përmbarrimor P.nr.122/23 të dt.02.06.2023, me arsyetimin se duke u bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*. Po ashtu, Kjo gjykate vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi nr. 4224, i datës 27.10.2020, mbi bazën e të cilit përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin, është bërë i plotfuqishëm dhe mban vullën e ekzekutueshmërisë së datës 31.01.2022, dhe rrjedhimisht i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36, paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarrim, organit përmbarrues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarrues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarrueshmëris për përmbarrueshmëri”*, ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarrueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*.

Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së Dytë, vlerëson se , Dhomat e Shkallës së Parë drejt ka vlerësues dokumentin përmbarrimor përkatësisht Aktvendimin mbi bazën e të cilit përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin, ku ka gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarrues sipas të cilit mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata vlerëson se Aktvendimi mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në kuptim të nenit 27 paragrafin 1, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit,

dhe në këtë rast i plotëson kushtet për të qene dokument përmbartimor me titull ekzekutiv, sepse i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 21 dhe 22 të LPP-së.

Andaj, Gjykata Komerciale – dhoma e shkallës së dytë vlerëson së gjykata e shkallës së parë drejte ka vendosur kur e ka refuzuar në tërësi prapësimin e debitorit, me arsyetimin se në bazë të shkresave të lendes rezultoi se vendimi mbi të cilin përmbartuesi privat e ka lejuar urdhrin përmbartimor të debitorit paraqet dokument përmbartimor në kuptim të dispozitave të LPP-së, për shkak se përmban vulën e ekzekutueshmërisë dhe plotfuqishmërisë, si dhe vendimi mbi bazën e të cilit është nxjerrë urdhri përmbartimor i plotëson kushtet në kuptim të nenit 22 par.1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimor.

Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i vlerësoi të gjitha pretendimet ankimore të debitorit por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitorë për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e mos kryerjes së përmbartimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbartimore. Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar prapësimin e debitorit dhe e ka lënë në fuqi urdhrin për caktimin e përmbartimit të Përmbartuesit Privat, P.nr.926/2015 të dt. 17.06.2015.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K.DH.SHK.II.nr.1588/23 dt. 14.02.2024

**Gjyqtari,
Ramush Bardiqi**